



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/224
Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-176 dhe Ligjin Nr.08/L-248, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:


V E N D I M

1. Aprovohet rritja e shumës së përfitimit të skemave Pensionale të financuara nga shteti duke filluar nga muaji tetor 2024, për skemat dhe nën-programet si në vijim:
 - 1.1. Pensionet bazike – sociale, nga shuma aktuale prej njëqind euro (100.00€) në shumën prej njëqind e njëzetë euro (120.00€), me kod buxhetor 00100;
 - 1.2. Pensioni kontributdhënës I – nga shuma aktuale prej njëqind e tetëdhjetë e dy euro (182.00€) në shumën prej dyqind e tetëmbëdhjetë euro e dyzetë cent (218.40€), me kod buxhetor 01200;
 - 1.3. Pensioni kontributdhënës II – nga shuma aktuale prej njëqind e nëntëdhjetë e tetë euro (198.00€) në shumën prej dyqind e tridhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë cent (237.60€), me kod buxhetor 01200;
 - 1.4. Pensioni kontributdhënës III – nga shuma aktuale prej dyqind e katërmëdhjetë euro (214.00€) në shumën prej dyqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë cent (256.80€), me kod buxhetor 01200;
 - 1.5. Pensioni kontributdhënës IV – nga shuma aktuale prej dyqind e gjashtëdhjetë e pesë euro (265€) në shumën prej treqind e tetëmbëdhjetë euro (318€), me kod buxhetor 01200;
 - 1.6. Skema e fëmijëve me aftësi të kufizuar 1-18 – nga shuma aktuale prej njëqind euro (100€) në shumën prej njëqind e njëzetë euro (120€), me kod buxhetor 00600;
 - 1.7. Pensionet e aftësisë së kufizuar – nga shuma aktuale prej njëqind euro (100€) në shumën prej njëqind e njëzetë euro (120€), me kod buxhetor 00200;
 - 1.8. Pensioni për personat e verbër I – nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë e pesë plus njëqind e njëzetë e pesë euro (125+125€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë plus njëqind e pesëdhjetë euro (150+150€), me kod buxhetor 02700;
 - 1.9. Pensioni për personat e verbër II – nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë e pesë euro (125€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (150€), me kod buxhetor 02700;
 - 1.10. Pensioni për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë I – nga shuma aktuale prej njëqind e pesëdhjetë plus njëqind e pesëdhjetë euro (150+150€) në shumën prej njëqind e tetëdhjetë plus njëqind e tetëdhjetë euro (180+180€), me kod buxhetor 03100;
 - 1.11. Pensioni për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë II – nga shuma aktuale prej njëqind e pesëdhjetë euro (150€) në shumën prej njëqind e tetëdhjetë euro (180€), me kod buxhetor 03100;
 - 1.12. Pensioni familjar – nga shuma aktuale prej njëqind euro (100€) në shumën prej njëqind e njëzetë euro (120€), me kod buxhetor 02900;

- 1.13. Pensioni invalidor i punës - nga shuma aktuale prej njëqind euro (100€) në shumën prej njëqind e njëzetë euro (120€), me kod buxhetor 03000;
- 1.14. Pensioni i parakohshëm për Trepçën - nga shuma aktuale prej njëqind e njëzetë e gjashtë euro (126€) në shumën prej njëqind e pesëdhjetë e një euro e njëzetë cent (151.20€), me kod buxhetor 00400;

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/224
Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë, në këtë përbërje:
 - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, kryesuese;
 - Naim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, anëtar;
 - Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - Florina Mehaj-Kosumi, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, anëtare dhe
 - Enis Spahiu, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/224

Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, kryesuese;
 - 1.2. Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - 1.3. Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - 1.4. Florina Mehaj-Kosumi, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, anëtare dhe
 - 1.5. Enis Spahiu, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
2. Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/224

Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale e datës 9 tetor 2024 për konfirmimin e interesit të përgjithshëm publik në ushtrimin e aktiviteteve përkatëse nga Ndërmarrja Publike "Korporata Energjetike e Kosovës" Sh. A.
2. Konfirmimi nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet me qëllim të aprovimit të lëshimit të licencës nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për interes të përgjithshëm publik, duke marrë parasysh aspektin ekonomik dhe social të zhvillimit të "Korporata Energjetike e Kosovës Sh. A. në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/224
Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007, neni 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej dyqind mijë euro (200,000.00€), për ofrimin e ndihmës për rimëkëmbje nga fatkeqësia natyrore/vërshimet e ndodhura në Bosnje e Hercegovinë.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari të sigurojë llogarinë për transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/224
Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit për Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Programi për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike për vitin 2024-2025.
- Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që me vendime të veçanta të përcaktojë kushtet dhe kriteret për përfitim nga Programi sipas pikës 1. të këtij vendimi.
- Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/224
Datë: 11.10.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 8. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të Promovimit të Republikës së Kosovës, ndahen mjete buxhetore në vlerë prej 200,000 € (dyqind mijë euro) për Olimpiadën Evropiane të Vajzave në Matematikë (EGMO) 2025, të organizuar nga Shoqata e Matematikanëve të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe barten në xhirologarinë e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë